



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-10977/20 datë:01.07.2020



Npi – 01/160 datë: 09.07.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 09.07.2020 është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

**I MBLEDHJES SË -V- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**

E mbajtur më: 09.07.2020, e (enjte) në ora 10.<sup>00</sup> h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shekki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, znj.Arresha Syla, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamed Ademaj, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi, Drejtori; znj.Havë Qarri, znj.Agime Roshaj; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Përgjegjësi i ZKKK-së, z.Ibrahim Demiri; Zyrtarët e IT-së Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjafsheshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Pyetje-përgjigje,
2. Raport për Covid-19,
3. Draft-Rregullorja Komunale per Mbrojtjen e Fëmijës,
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë,
5. Informate nga DKA përfundimin e procesit mësimor,
6. Draft-Plani i Punës të KKSB-ë për vitin 2020-21, (pas diskutimit publik)
7. Informatë nga KKSB,
8. Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)
9. Shqyrtimi i Kërkesave.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, desha të ju njoftoj se ne e kemi menduar edhe variantin që mbledhjen me e mbajtur si hera tjeter në sallën e Shtëpisë së Kulturës, por për shkak të Pandemisë KOVID19, kemi ardhur në përfundim se shumë më mirë është me e mbajtur këtu në sallën e Kuvendit për shkaqe teknike edhe të zërimit edhe të inqizimit, por me kushte pak më rigorozë duke mbajtë maska dhe duke respektuar distancën. Në vazhdim propozoj që në rendin e ditës ta fusim edhe një pikë shtesë si pikë e parë e rendit të ditës: “Deklaratë, për mbrojtjen e

vlerave të luftës së UÇK-së” , ndërsa për pikën e parë Pyetje-Përgjigje propozoj që të bëhet me E-mail nga ana juaj si këshilltar të Kuvendit Komunal.

**z.Shefki Dauti;** Përshëndetje, në emër të grupit të anëtarëve të Kuvendit nga PDK-ja pajtohem që Pyetje-Përgjigje të bëhen me E-mail.

**z.Ruzhdi Jashari;** Përshëndetje, unë nuk do ta zgjasë por po kërkoi futjen e një pike shtesë në rendin e ditës, fjala është për usurpimin e oborrit të shkollës fillore “Emin Duraku” në Shtime kërkoi që me u qitë në rendin e ditës, dhe me diskutuar për te.

**z.Fehmi Hysenaj;** Përshëndetje, unë jam që Deklarata të jetë si pikë e parë e rendit të ditës. Nuk kemi asnjë përgjigje për pikën e parë të rendit të ditës Pyetje-Përgjigje, propozoj që kjo të qvendoset në pikën e dytë. Sa i përket propozimit të Ruzhdiut unë propozoj që kjo të jetë si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e radhës, me qëllim që të paisemi me material të nevojshëm. Edhe një qështje tjetër ne duhet gjithsesi ta zgjidhim problemin e votimit të rendit të ditës, nëse është nevoja ta ndryshojmë edhe rregulloren e punës së Kuvendit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë po deshiroj që të sqaros për sa i përket votimit të rendit të ditës se Rregullorja e punës së Kuvendit është miratuar po nga ky Kuvend, dhe kjo rregullore është hartuar nga një Komision i po këtijë Kuvendi. Ne tani duhet që këtë rregullore ta respektojmë, ashtu qysh shkruan aty, dhe unë pikërisht këtë po e bëj.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, po lidhem me propozimin për Deklaratën, ne si delegatë nuk duhet të diskutojmë, sepse fare nuk ka të bëj me temën që po kërkohet të diskutohet.

**Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi;** Përshëndetje, Gati të gjitha Komunat e kanë miratuar një deklaratë të tillë, dhe nuk është qudi të dëgjohet një qëndrim anti UÇK-së prej juve të Vetvendosjes.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, unë propozimin e Ruzhdiut e përkrahu, por për mbledhjen e radhës e jo për sot.

**z.Isak Muslija;** Përshëndetje, unë nuk pajtohem me ate që tha Kryesuesja, sepse unë mendoj se propozimet për qështje të ndryshme, që të gjitha duhet të qiten në votim, ndërsa kjo “Mosqitja në votim e propozimeve tjera të qështjes së njejtë” do të kishte kuptim vetem nëse bëhet fjalë dmth. për qështje të njejtë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Edhe një herë, unë po e lexoi nenin 6.2 që e rregullon qështjen e votimit të rendit të ditës. Unë pra së pari do ta qes në votim propozimin e parë që ka ardhur pa Deklaratën. Në vazhdim Konstatoi Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, me 0 vota “Për” me 17 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” nuk e aprovoi Rendin e Ditës të propozuar nga Kryesuesja në bashkpunim me Kryetarin që nënkupton pa “Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së”.**

\* **Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 5 votë “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës, me propozimin e Kryesueses, q; pika e parë shtesë të jetë “Deklarata për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së”, ndërsa për pikën “Pyetje-Përgjigje” Pyetjet të dërgohen me E-mail si vijon:**

1. Deklaratë, për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,
2. Raport për Covid-19,
3. Draft-Rregullorja Komunale per Mbrojtjen e Fëmijës,
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Kom. për ndarjen e bursave për Studentë,
5. Informate nga DKA përfundimin e procesit mësimor,
6. Draft-Plani i Punës të KKSBB-ë për vitin 2020-21, (pas diskutimit publik)
7. Informatë nga KKSBB,
8. Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)
9. Shqyrtimi i Kërkesave.

## Pika 1 (Shtesë)

### Deklarata për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

**Kryesuesja, znj. Medina Brahaj;** Në vazhdim lexoi Draft- Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Sa i përket Deklaratës, Besniku e filloj një diskutim ku tha se Lëvizja Vetvendosje e ka kundërshtuar formimin e Gjykatës Speciale, unë do ta vazhdoj se edhe z.Fatmir Limaj e ka kundërshtuar ashpër, mirëpo ne si subjekt politik jemi për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së. Ne duhet fuqishëm ti mbrojmë këto dy figura të luftës së UÇK-së, pa marrë parasysh se kush atëherë ka votuar për formimin e Gjykatës Speciale. Tani ne duhet të jemi bashkë, dhe të jemi "Për" për tri shkronjat e arta UÇK. Dhe kushdo që padrejtësisht akuzohet Nisma Social Demokrate fuqishëm do ta kundërshtojë. Kjo Deklaratë e merr në mbrojtje Hashim Thaqin dhe Kadri Veselin si udhëheqës të UÇK-së.

**z.Shekfi Dauti;** Secili që e ndien veten Shqiptar, duhet ti vie keq për marrjen dhe arrestimin e figurave të UÇK-së. Nuk bën që sot të bëhet politikë me Gjykatën Speciale. Kur akuzohet prijesi i UÇK-së, është e kuptueshme që po bëhet fjalë konkretisht për UÇK-në. Politika shkon e vjen por UÇK-ja do të mbetet për gjithëmonë.

**z.Besnik Seferi;** Është shumë keq që Nënkyetari i Komunës flet kështu, se ne si Vetvendosje jemi kundër UÇK-së. Unë distancohem nga këto fjalë të Nënkyetarit. Unë kam familjar në UÇK-ë. Tu kisha lutë që të mos flisni gjëra të tilla, është turpësi për ju si Nënkyetar. Unë kërkoj që ju të térhiqeni nga kjo fjalë e juaj e thënë në këtë Kuvend. Ne kemi dëshmuar kur ka qenë koha e luftës por edhe sot vazhdojmë të dëshmojmë me punë se jemi në përkrahje të plotë të UÇK-së. Po dua që të potencoj se ne nuk jemi kundër një deklarate të tillë për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së. Në vazhdim lexoi tekstin e diskutimit të tijë të shkruar.

**z.Isak Muslija;** Nënkyetari, nuk përmendi emra por UÇK-në. Është qështje shumë e ndieshme kjo, kemi edhe mospajtime. Siq e dini unë jam arrestuar nga Tribunali i Hagës, pastaj Balaj e pastaj edhe Limaj, dhe askush nuk ka reaguar, e kam fjalën Shteti nuk ka reaguar dhe kjo për mua ka qenë e pa kuptueshme. Madje ka thirrje për ta dënuar UÇK-në, po mjafton vetem për ta përmendur Shkëlzen Gashin, por jo Lëvizja Vetvendosje. Gjykata ndërkombëtare donta ta sillte në Gjykatë Reqakun, dmth. për mes meje ta sillte aty Reqakun. Në Hagë unë i kam kaluar 33 muaj. Akuzë atëher kundër Hashimit, e Kadriut nuk ka pasë. U dashke patjetër me qenë të akuzuar tre persona për me mujt me akuzuar një grup. Pastaj në Gjykatë e sollën edhe fajtorin kryesor të luftës Millosheviqin. Për të mos hyrë më shumë në këtë temë unë po dua të them se Gjykata Speciale është plotësisht e pa arsyeshme, sepse të mirret sot në Gjykatën Speciale një drejtë politik i UÇK-së, unë mendoj se nuk ka mundësi, për këtë arsy unë mendoj se nuk do të ketë fare aktakuzë. Sa i përket Deklaratës në tekstin e sajë duhet të ketë përvëq Hashim Thaqit dhe Kadri Veseli edhe fjalët dhe të tjerët, ndryshe do të jetë gabim, nëse nuk përfshihen edhe të tjerët që ishin meritor në luftën e UÇK-së. Pas 21 Qershorit akuzat që ngriten anti UÇK-së, tentohet te barazohet Serbia me krimet që i ka bërë në Kosovë. Kam pas për të diskutuar shumë por po e përfundoj me kaq.

**z.Ruzhdi Jashari;** Në fillim dua që ti heqim disa dilema, ne nuk jemi kundër për ta nxjerrë një deklaratë të fuqishme për të mbrojtur vlerat e luftës së UÇK-së. Këto dilema nuk janë sot edhe aq të rralla. Unë po them lumë ata deputet që nuk e kanë ngritur dorën për ta themeluar një Gjykatë të tillë për të gjykuar një ushtri të një populli e cila luftoi për ta mbrojtur jetën e vet, e jo edhe për ta gjykuar një ushtri e polici të Serbisë agresore që kreu krimë e masakra në popullatën shqiptare. Gabime fatale janë bërë kur jan quar gishtat për formimin e Gjykatës Speciale. Të hiqen dilemat, Albin Kurti ka qenë Sekretar Administrativ i zyres së UÇK-së, për takime në Prishtinë, këto qka po fliten këtu janë prallë të dikujt. Qështje tjetër e dhimbshme sipas meje është kur ka shkuar Isak Muslija në Hagë, unë e kam pas një Kredi të familjes dhe jamë shumë i lumtur që kam marrë pjesë dhe kam kontribuar në mbrojtje në këtë proces gjyqësor me dinjitet, ku këta kanë dalë para syve të botës dhe kanë treguar pafajësinë e UÇK-së. Është e dhimbshme, sepse ne e dimë se qka ka pasur për brenda, sepse nja tri vjet e kemi pa. Kemi pa qindra e mijra deklarata aty edhe të atyre që kanë qenë kundër luftës për liri edhe të atyre, aty

kemi pa deklarata që kanë qenë në kundërshtim të plotë me vlerat e Lirisë. Mirëpo aty kemi pa sihariq deklarimet e dy avokatëve eminent që ne po e kthejmë këtë padi kundër UÇK-së në një padi kundër Serbisë. Hashimin dhe Kadriun unë i shoh si pjesë të luftës e jo si pjesë të partive politike, janë bërë gabime pas lufte. Nuk guxon kjo deklaratë me shkuar kështu veq për Hashimin e Kadriun, në deklaratë duhet të shkruhet përfaqësuesit dhe luftëtarët e UÇK-së. Ka pasur edhe aktivitete politike nga ana jonë, tryezën e parë Anty Dick Marty bashkë me këta kolegët këtu e kami mbajtur pikërisht në Reqak, më pastaj tryezën tjetër të dytë për këtë temë, me insistimin tim e kemi mbajtur në Prishtinë, deri sa disa që sot po thrrasin në protesta as që kanë dashur me ni thoshin, "hajt se krejt bota e dinë". Nuk kemi punuar, duke menduar se të tjerët do të na i zgjidhin problemet tona. Qe 20 vjet nuk ka pasë padi kundër Serbisë, për krimet dhe shkatrrimin e Kosovës. Ne e mbështesim deklaratën por me përmirësimin që duhet ti bëhet e që e propozova.

**z.Perparim Ramusa;** Përshëndetje, unë jam për ta aprovuar këtë deklaratë. Unë mendoj se nëse ne kemi me qka me u krenuar ajo është lufta për liri e UÇK-së. Unë nuk jam që kësaj qështje ti japid ngjyrime politike. Jam që ta përkrahim dhe ta votojmë kaq.

**znj.Arbresha Syla;** Përshëndetje, unë e them me krenari se pjesa më e ndritur e popullit tonë është lufat për liri e UÇK-së, vlerë e pa kontestueshme, gjithësesi që është mbi partiake. Pajtohem me Perparimin që duhet ti tejkalojmë ndasitë, sepse po rrezikohet qenia e shtetësisë tonë. Më vjen keq që Kuvendet e mëhershme nuk e kanë bërë një deklaratë të tillë për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së. Ishte pra mundësia e vetme që populli të vetorganizohet në vetëmbrojtje, UÇK-ja, mori përsipër këtë detyrë shumë të rëndë ishte pra mundësia e vetme që ne të mbetemi gjallë. Secili që e ka kapë pushkën nuk e ka ditur se do ta gjëzojë lirinë. Prandaj sot të jeshë kundër një deklaratë të tillë do të jetë të jeshë vetë krimi. PDK-ja në kohën e formimit të kësaj Gjykate Speciale ka pas deklaruar se ka pas presion, se një Gjykatë të tillë do ta formonte OKB-ja nëse nuk do të votohej kjo. Pastaj ka qenë edhe kërkesë e njerëzve që na kanë ndihmuar që të qirohemi. Ku kenë partitë tona Shqiptare që ikshin si pulat për me vendos që të zhbëhet Gjykata Speciale, ku ken qat"herë, a ban me pas këtë përgjigje? Por jo sepse qasja e tyre ishte, që mu eleminu këta, ne në pushtet vimë më lehtë. Sigurisht që ne e përkrahim këtë deklaratë dhe do ta votojmë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Është për keqardhje se far niveli të debatit kemi ra, qytetarët po na përcjellin, dhe nëse nuk respektohet fjala e lirë vërtetë është e turpshme për ne. Po kërkoj vazhdimisht që të respektohet fjala, dhe të dëgjohet njëri me tjetrin.

**z.Isak Muslija;** Unë po i përgjigjem Arbreshës, pasi që unë i kam takuar Aleancës që nuk e ka votuar formimin e Gjykatës Speciale, dhe kolegja Arbresha bëri thirrje me pyetjen, pse ikën partitë kur PDK-ja bëri thirrje për ta zhËberë Gjykatën Speciale. Unë po i përgjigjem vetëm me pyetjen pse e themeluan atë? Mirëpo, desha ta them një qështje tjetër që është shumë e rëndësishme, qarqe të caktuara politike, grupe të caktuara të interesit aludonin se arsyeva është se Hashim Thaqi e formoi një Gjykatë Speciale për me i dërguar ushtarët e vet në burg, e vet me nejt në Prishtinë e fëmijët me i qu me i shkollu në Amerikë. Kjo do të ishte shumë e rrezikshme për Kosovën, sepse unë nuk do të pranoja me shku në burg pa shefin tim, pse ai me më qu mua në burg e ai me nejt në Prishtinë. Kjo pi bje që Gjykata Speciale po ngrit Aktakuz kundër Hashim Thaqit, që është fatbardhësi, sepse duhet me thanë qka kam unë që nuk shkoj në atë Gjykatë, sepse vetëm ne udhëheqësit e ushtrisë dimë ta mbrojmë më së miri UÇK-ë.

**z.Fehmi Hysenaj;** E falënderoj Arbreshën për mundësinë e replikës. Unë e shoh shqetësues deklarimin e Nënkyetarit, Rrahman Jakupi për subjektin politik të Vetvendosjes si anti UÇK-ë, dhe kërkoj që të tërhoqet nga ky deklarim për hirë të unitetit, edhe përkundër asaj që ne e shohim si të heshtur Vetvendosjen në këtë qështje, por ka qenë e heshtur edhe kur është thirrë Rexhep Selimi. Megjithatë unë jam thellë i bindur se nuk ka subjekt politik Shqiptar që është kundër UÇK-ë. Figurat e luftës kanë qenë të pastra dhe si të tilla ne duhet ti mbrojmë, deri sa të mos vërtetohet e kundërtë, nëse vërtetohet do të ishte shumë e keqe për ne. Kështu që Nënkyetari ta tërheq fjalën dhe ne si Kuvend ta aprovojmë deklaratën.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, unë e përkrahu deklaratën, edhe pse unë mendoj se do të ishte shumë më mirë që ta kishim një Ligj për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, se sa një deklaratë. Unë nuk e shoh këtu vetëm Hashim Thaqin dhe Kadri Veselin, por e shoh të gjithë UÇK-në. Unë e përkrahu edhe deklaratën por e përkrahu edhe protestën që pas pak do të mbahet, kështu që unë po ju njoftoj se do të jem pjesë e kësaj proteste.

**z.Naim Zejna;** Përshëndetje, unë nuk po dua që të polemizojmë për këtë qështje sepse më e mira do të ishte që të organizohej ndonjë simpozium shkencor për tu sqaruar më mirë gjërat. Themelimi i Gjykatës na është imponuar. UÇK-ja është e popullit, nuk është e asnjë partie politike dhe kështu si e popullit edhe duhet të trajtohet. Deklarata duhet të jetë më e rafinuar pra që në deklaratë duhet të përfshihen edhe fjalët, edhe të tjerët që mund të janë të ndjekur nga Gjykata Speciale. Unë propozoj konkretisht që te pika e 5 e deklaratës të përfshihen edhe fjalët “dhe të tjerët” sepse janë të barazvlefshëm.

**znj.Adelina Beqa;** Përshëndetje, unë mendoj se deklarata është shumë e vlefshme. Nuk bën të lejojmë që kjo qështje për shkaqe politike të kalojë në banalitet. Unë mburrem me UÇK-në, dhe pa dyshim që e përkrahu deklaratën dhe do ta votoj.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, deklaratën duhet ta përkrahim. Ne kemi qenë kundër formimit të Gjykatës Speciale, por edhe sot jemi kundër. Mbi bazën e kësaj dhe shumë argumenteve të tjera ne jemi përkrahës të kësaj deklarate dhe do ta votojmë.

**znj.Zarife Rexhaj;** Përshëndetje, unë e përkrahu këtë deklaratë, (më tutje nuk është kuptuar as nga stenogrami)

**Nënkyetari, z.Rahman Jakupi;** Të nderuar Këshilltar të Kuvendit ju kisha lutë për pak vëmendje. Fillimi shtu informoj se unë i kam 40 vjet, dhe ngritia e toneve dhe paraqitja kishe se unë jam lider, te unë nuk pinë ujë këto sene. E dyta unë kam nderin që kam qenë pjestar i UÇK-ë, në moshën 19 vjeçare, që ndihem shumë krenar për atë pjesë. Tjetra nuk më keni dëgjuar me vëmendje, unë nuk kam folë në aspektin individual, edhe unë nuk kisha tërheq fjalën nëse Albin Kurti si ish Kryeministër kur ka qenë të mos kishte kërkuar nga Prokurori Special të veprojë më shpejt, pasi që nuk po e them unë por këtë e ka thënë ish deputeti i Nismës z.Milaim Zeka. Tjetra Shkëlzen Gashi i ka akuzuar UÇK-ë, publikisht për vrasjen e 1000 civilëve, nuk e ka përmend kurrë Masakrën e Reqakut, nuk i ka përmendur kurrë vrasjen e 21 fëmijëve që janë vra në Komunën e Shtimes. Unë e tërheqi deklaratën time kur këta individ si përfaqësues politik i tërheqin këto fjalë. Drita Millaku deputete e Kuvendit të Kosovës, anëtarë e Vetvendosjes e ka deklaratën e saj publike, dhe kur ta tërhek ajo deklaratën e saj edhe unë e tërheqi deklaratën time. Kur ka qenë Ramush Haradinaj i Arrestuar për në Hagë ne kemi dalë në protesët nuk po më kujtohet koha kur por unë kam qenë sekretar i PDK-së këtu, dhe nëse nuk gaboj kemi bërë edhe një deklaratë në Kuvendin e Komunës, kështu që kjo nuk është hera e parë. U tha se Kuvendi i Komunës nuk ka kompetenca, Kuvendi i Komunës ka kompetenca për me bërë një deklaratë, që i mbronë vlerat e luftës së UÇK-ë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, me ndryshimin që te pika e 5 të shtohen edhe fjalët “dhe të tjerët”.**

**Pika 2**  
**Raport për Covid-19**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

**Nënkyetari, z.Rahman Jakupi;** Sot kemi 8 raste aktive me virusin Korona (KOVID19). Meqenëse informatën e keni të shkruar dhe e keni marrë me kohë unë nuk do të vazhdoj më tutje, por i mirpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbresha Syla;** Te kjo pjesë e menaxhimit të pandemisë KOVID19 e keni pa edhe vetë se është bërë një punë e madhe dhe punë e mirë në QKMF-ë. Ne kemi qëndruar aty dhe jemi përballur me virusin. Që nga fillimi ne kemi qenë të paisur me mjete mbrojtëse. E falënderoj Kryetarin dhe

Nën kryetarin që na kanë mbështetur. Edhe pjesa e Komunës është organizuar mjaft mirë, duke e themeluar Shtabin Emërgjent, si dhe menaxhimin me shpërndarjen e ndihmave për qytetarët. Tani ne si staf mjekosor kërkojmë që qytetarët të janë të kujdeshëm, sepse virusi është prezent më afër se kurri. Reagimi me Inspektor është i duhur. Mbajtja e maskave mbrojtëse, mbajtja e distancës janë të domosdoshme, ndërsa lëvizja në grumbuj është e pa lejueshme. Duhet të kemi edhe më shumë kujdes.

**z.Ruzhdi Jashari;** Transmetimi i mbledhjes përmes rrjeteve sociale herë po bëhet e herë nuk po bëhet. Meqenëse tani ka transmetim, po bëjmë apel që ta ruajmë njëri tjetërin duke respektuar masat e sigurisë në mënyrën më rigorozë, sepse gjendja është shumë e rëndë. Kemi pas mbi 200 të infektuar, mendoj se gjendja sa i përket virusit është jashtë kontrollit. Prandaj nevoitet të kemi shumë kujdes qoftë në mbajtjen e maskave qoftë në mbajtjen e distancës. Sa i përket raportit, blerjet janë bërë me procedurë të negocijimit, që lënë shumë për të dëshiruar, sepse këto realisht e mënjanojnë krejtësisht konkurrencën. Nuk kemi raport te aspekti i blerjeve të mjeteve mbrojtëse në QKMF-ë. Nuk kemi një informatë për blerjet e Pakove Ushqimore. Pastaj edhe brenda raportit kemi informata kundërshtuese, ndërkaq që kur është miratuar buxheti për Pandeminë, Kryetari ka pas deklaruar se do të raportojmë në Kuvend cent për cent. Tani ne nuk e kemi një raport të tillë, madje nuk e dimë edhe sa mjete janë në dipozicion ose edhe sa kanë tepruar. Me një fjalë mund të konstatojmë se raporti është i mangët.

**znj.Adelina Beqaj;** Unë desha të ja bëj një pyetje drejtorit të DSHMS-ë, ne në Qendrën për Punë Sociale në Shtime nuk jemi paisur me mjete mbrojtëse kundër Pandemisë KOVID19, kur dihet se jemi institucion që kemi kontakte mjaft shumë me njerëz? Dhe një pyetje tjeter, a do të fillojë prap shpërndarja e pakove ushqimore sepse ka kërkesa mjaft shumë?

**z.Fehmi Hysenaj;** Falënderoj për raportin. Sa kemi pa ne gjendja është menaxhuar mirë. Mirëpo është për keqardhje shfaqja e rasteve të reja të infektimit me virus. Po ashtu është shqetësues kur një rast ka rezultuar pozitiv dhe nuk e ka mbajtur izolin. Pastaj për keqardhje është edhe rasti i një familje që janë duke pritur me javë për tu testuar por nuk po ndodhë. Komuna duhet të bëj presion dhe të myllen vratat e Pandemisë. Unë propozoj që të miratojmë një Komunikatë në formë thirrje për të respektuar masat kundër KOVID19.

**z.Naim Zejna;** Ne e mbështetem deklaratën dhe tani po kërkojmë respektimin e masave të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, e pastaj edhe po thuhet për me dalë në protestë, kjo nuk shkon, dhe mendoj se nuk ka nevojë për me dalë në protestë.

**z.Reshat Mujota;** Unë nuk bëra thirrje për me dalë në protestë, por vetëm thash se unë do të dal në protestë.

**znj.Zarife Rexhaj;** Unë jam që të vazhdojmë me mbledhjen meqenëse kemi Kuorum. Të diskutojmë për raportin dhe ta miratojmë atë.

**z.Musa Baftiu, drejtor i DSHMS;** Përrshëndetje, nuk dua të flas për Shtabin Emërgjent e për Partitë, por po kyqem drejtpërdrejt në raport. Në raport janë të prezantuara si vlera financiare të përgjithshme Pakot Ushqimore. Nuk qëndron konstatimi i Adelina Beqaj se nuk janë paisur me mjete mbrojtëse Qendra për Punë Sociale. Shpërndarja e pakove Ushqimore nuk ka përfunduar, është në vazhdim e sipër kështu që edhe dje kemi qu dy pako. Kërkoj që me ju përbajtë masave mbrojtëse nga Pandemia KOVID19. Testet i cakton Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik, me qka edhe ne nuk jemi të kënaqur, por këto janë mundësitë.

**z.Rexhep Gashi;** E përrshëndes raportin, e pashë që rapporti ishte bërë në vija të trasha. Nuk është përfshi ana financiare. Është për keqardhje irritja e numrit të rasteve të infektuara me KOVID19. Unë po shpresoj se në të ardhmen ZKF-ja do të na e prezantoj një raport të detajuar financiar për sa i përket Pandemisë.

**z.Naim Zejna;** Nëse gjendja është alarmante, atëherë ne duhet që ti ikim takimeve. Kështu pra po bëhen thirrje, dhe mbi bazën e kësaj unë nuk po e shoh të arsyeshme për me dalë në protestë, aq më shumë kur sa e miratuam një deklaratë pikërisht për këtë qëllim. Unë po kërkoj që rasteve aktive tu bëhet një kontrollë më rigorozë, sepse ka raste që po dalin në jetën publike. Testimet duhen të bëhen në rastet kur vërehen simptomat. Duhet të kërkojmë nga drejtori që edhe Policia edhe Inspektorati të janë më aktivë.

**zpj.Fatmire Ferati;** Përshëndetje, raporti tregon punën që është bërë në kohë Pandemie, është për ta falënderuar Kryetarin, Shtabin Emërgjent por edhe punëtorët shëndetësor e të tjera të gjithë që punuan pa u ndalur për ta penguar përhapjen e Pandemisë KOVID19. Një falënderim i vaqantë edhe për Donatorët. Sa i përket anës financiare është publike dhe mundeni me e pa secili. Virusi është ende aktual, prandaj unë bëj thirrje të kemi kujdes të shtuar për respektimin e masave mbrojtëse tashmë të përsëritura disa herë të IKSHP-së. Në fund unë po propozoj që të bëjmë një pauzë të shkurtër.

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Edhe unë bëj thirrje nga Kuvendi që të respektohen masat mbrojtëse nga IKSHP-ja, sepse në fund vetë secili për veti do ti bartë pasojat.

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 11 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, me 9 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" aprovoi Raportin për Covid-19.**

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Dha një orë Pauzë, deri në ora 13.00h.

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Vazhdojmë me mbledhjen ora është 13.07h.

### Pika 3

#### Draft-Rregullorja Komunale per Mbrojtjen e Fëmijës

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që diskutime nuk kishte Kryesuesja Konstatoi Kuorumin, prej 14 anëtarëve prezent në mbledhje

\* **Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Rregullorja Komunale per Mbrojtjen e Fëmijës, në afatin prej 15 ditësh.**

### Pika 4

#### Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Agime Roshaj.

**zj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi para Kuvendit, Propozim-Vendimin për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë, tani i mirpres pyetjet nga ana juaj, dhe po ashtu pres që ta miratoni këtë Propozim-Vendim, (shih dokumentin).

**z.Naim Zejna;** Ne si LDK-ë jemi për formimin e këtijë Komisioni, dhe propozj zpj.Zarife Rexhaj.

**z.Shekfi Dauti;** Nga PDK-ë propozojmë Herolind Selmanin.

**z.Ruzhdi Jashari;** Ne në mbledhjen paraprake kemi vendosur që të vazhdojë e njejta përbërje e Komisionit.

**z.Rexhep Gashi;** Komisioni paraprak e ka kryer detyrën mirë, kështu që unë propozoj që të mbeten të njëjtë abëtarë të Komisionit me të njëjtin format.

**z.Muhamed Ademaj;** Unë mendoj se Komisioni duhet me u ndryshuar, me qëllim që me ju dhënë mundësia se cilët deputet për me qenë anëtarë i këtijë Komisioni.

**z.Isak Muslija;** Ne jemi për këtë format, mirëpo nëse një grup dëshiron me e ndryshuar kandidatin e tijë atëherë le ta bëj brenda grupeve këtë ndryshim.

**Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, me 12 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 4 votë "Abstenim" vendosi që zpj.Zarife Rexhaj, të jetë anëtarë e Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë.**

\* **Kuvendi i Komunës, me 13 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 votë "Abstenim" vendosi që zj.Herolind Selmani, të jetë anëtarë i Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë.**

\* **Kuvendi i Komunës, me 13 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 votë "Abstenim" aprovoi Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit për ndarjen e Bursave për Studentë, nga gjithsejtë 5 (pesë) anëtarë sa është paraparë me rregullore, si vijon:**

1. z.Herolind Selmani.....(Përfaqësues i pozitës)

2. znj.Zarife Rexhaj.....(Përfaqësuese e opozitës)

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, me numër 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/308 të datës 14.07.2020 si vijon:

3. z.Fatmir Zymeri .....( Zyrtar për Arsim )

4. znj.Ardita Ndrecaj.....( Zyrtare e Personelit )

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, e dërgojnë përfaqësuesit e Studentëve ose shoqërisë civile, si vijon:

5. z.Resul Gashi .....(Kryetar i Qendrës Rinore - Përfaqësues i OJQ-ve)

#### Pika 5

##### Informate nga DKA për përfundimin e procesit mësimor

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Agime Roshaj.

**znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA;** Lexoi tekstin e Informatës para delegatëve të Kuvendit. Informatën e kemi përgatitur të shkruar dhe e keni marrë me kohë. Unë i mirpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

**znj.Zarife Rexhaj;** Unë kam një pyetje për drejtoreshën, se a keni mbajtur evidenca për secilin mësimdhënës, sepse nuk kanë qenë ata të gjithë aktiv?

**z.Fehmi Hysenaj;** Faleminderit për raportin. Shihet që është bërë një punë e madhe e punëtorëve të arsimit, në kuadër të kushteve që i kemi pas. I falënderoj punëtorët për angazhimin e tyre. Qka do të ndodhë me ata nxënës të cilët nuk e kanë ndjekur mësimin on-line, sepse nuk është numnër i vogël prej 19 %, si do të notohen ata? Kjo pra është një informatë për një punë të frytshme por ne nuk duhet të rrimë duarkryq.

**z.Naim Zejna;** Faleminderit për Informatën, si pjesëmarrës i arsimit i dimë vështirësitet edhe në Komunat tjera, mirëpo mund të them se ne si Komunë e kemi organizuar mësimin on-line edhe më mirë se disa Komuna edhe më të mëdha edhe më të forta ekonomikisht. Është e vërtetë se ka pas mungesë të pisjeve dhe rrjetit të internetit. E di që ka punuar një Komision por po më intereson se a i keni vlerësuar më mirë, sepse ka ende raste të tilla pa paisje, mendoj se 80% është një vlerë e madhe e punës që është bërë.

**z.Herolind Selmani;** Faleminderit për raportin. Drejtoresha tha se janë konsultuar prindërit e nxënësve, unë desha ta pyes drejtoreshën, si është pra e mundur që fëmiu im nuk ka mbajtur mësim on-line, ndërkak që ka mbajtur kurs privatish ,për ta plotësuar mësimin. Besoj se kësi raste ka pas shumë, prandaj po pyes se si do të bëhet notimi i këtyre 19% të nxënësve.

**z.Muhamed Ademaj;** Faleminderit për Informatën, kemi disa data të shënuara në Informatë për përfundimin e procesit mësimor, e dimë se përfundon më 31 Gusht. Ka mbetur pra testi i arritshmërisë për klasët e nënta si dhe testi i maturës për klasët e dhjeta. 30% e mësimit është mbajtur on-line. Tash është më mirë me filluar, përgatitjet për vitin e ri shkollorë. Reformat në arsim nuk kanë dhënë rezultat. Sa drejtor i kemi Ushtrues Detyre, dhe kurë do të hapet konkursi?

**znj.Arbesha Syla;** Faleminderit për raportin. Po ndërlidhem te testet e arritshmërisë, ku një numër i nxënësve nuk e kanë përcjellë mësimin në distancë. Për klasët e 9 do ti nënshtrohen dy palë testeve, unë mendoj se duhet ta rishikoni edhe njëherë, mundësinë që testi i arritshmërisë të anulohet komplekt, e di që nuk është kompetencë e nivelit Komunal por ju ti qoni atje vërejtjet e juaja, me arsyetimin se një numër i madh i nxënësve nuk kanë pas mundësi me e përcjellë mësimin on-line. Unë po flas për klasët e 9 e jo edhe për maturantët, duke pas parasysh që situata veq po rëndohet.

**z.Ruzhdi Jashari;** Faleminderit për Informatën, janë gjërat që i ke pa dhe që janë punuar nga ana juaj e që i kemi pa edhe ne, prej aspektit të arritshmërisë në këtë kohë Pandemie. Gjendja e rëndë me Pandeminë KOVID19 i ka prekur të gjitha fushat. Po du me dal te qështja e ndihmesës të nxënësve sa do pak, sepse pjesë e arsimit jamë edhe vetë. Ne në univerzitet ku punoj i kemi mbajtur 82 mijë njësi

mësimore on-line, pa humbur asnë ditë, të gjitha njësitë mësimore janë të rexitruara. (Në vazhdim foli për tri Platforma Dijitalizuese te Univerziteti UBT). Nuk kemi informata për konkursin për zgjedhjen e drejtorave dhe zëvendës-drejtorave të shkollave. Pytje, a ka përfunduar shkolla fillore në Carralevë? Pse po kërkohen mjete shtesë për përfundimin e shkollës në Carralevë? A ka pasur të organizuar trajnime për mësimdhënësit lidhur me mësimin on-line?

**z.Shefki Dauti;** Faleminderit për Informatën, ngase kam qenë pjesë e procesit, unë mund të them se mësimi on-line është zhvilluar maksimalisht me mundësitë që i kemi pas. Kemi pas në dispozicion dy platforma 700m. Dhe Google Crome. Pyetje, si ekzekutiv i keni marrë 100,000€ që i ka nda Kuvendi, a ka qenë sfidë për arsim sasia e buxhetit të ndarë? Pyetja tjetër, si do të zhvillohet mësimi parashkollar, është shumë me interes për me ditë qytetarët? Pastaj, janë do dru qe një kohë në oborrin e shkollës profesionale, është mirë me bërë një zgjidhje për ato dru. Edhe përkundër vështirësive që kanë pas nxënësit me rrjetin e internetit disa prej tyre në kohën e mësimit kanë shkuar tek kojshit e tyre janë kyqë dhe i kanë përcjellë mësimet. Kujdes te shtuar nevoitet me pas te nxënësit e ciklit te ulët. Është keq me nxjerrë nxënës analafabet, sepse i kemi kushtet. Nxënësat kanë probleme thelbësore sidomos te shkencat natyrore e posaquerisht ne matematik.

**z.Reshat Mujota;** Faleminderit për Informatën, meqenëse këtu u fol për 460 Llapotpa, dhe gjindemi në kohën e Pandemis KOVID19, ku po nevoitet që mësimin nxënësat me e përcjellë on-line, a keni marrë masa konkrete që të gjithë nxënësat të kenë mundësinë që mësimin me e përcjellë on-line, meqenëse gjendja e pandemisë po vazhdon.

**znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA;** Informatën ne e kemi hartuar mbi bazën e raporteve të rregullta që na i sjellin drejtoret e shkollave. Sa i përket procesit të vlerësimit, ne kemi thënë që duhet të merret parasysh notimi i përgjithshëm dhe të nxirret nota mesatare, me qëllim që mos të dëmtohen nxënësit. Ka një numër i nxënësve që nuk kanë shprehur interesim e jo se nuk kanë pas paisje. Unë para së gjithash i falënderoj prindërit dhe i përgëzoj mësimdhënësit për punën e bërë. Sa i përket testit të arritshmërisë e kemi diskutuar dhe është shty për datën 20, sepse ende është diskutabile se a do të mbahet apo jo. Sa i përket 460 Llapotpëve, thash që i ka fituar Ministria e arsimit dhe unë kam qenë në komisionin Qendror për shpërndarjen e tyre mbi bazën e kritereve.

Konkursi për drejtor të shkollave është në procedurë e sipër dhe së shpejti do ta shpallim. Nuk ka përfunduar ende shkolla në Carralevë, për shkak se ende nuk është furnizuar me inventarë nga MASHTI. A ka ndikuar buxheti që e keni nda? Po ne kemi bërë disa ndarje nga ky buxhet. E përkrahu idenë që të vlerësohen nxënësit në parashkollar, dhe të vërtetohen mangësitë ose të metat nëse kanë fëmijët.

## Pika 6

### Draft-Plani i Punës të KKSB-ë për vitin 2020-21, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Pasi lexoi rekomandimin e KPF-së për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

**Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi;** Siq e dini Kuvendi ka marrë vendim për ta quar në diskutim publik Draft-Plani i Punës të KKSB-ë për vitin 2020-21. Diskutimin publik e kemi mbajtur dhe janë nxjerrë 8 rekomandime, me të cilat ju jeni njoftuar me kohë, prandaj unë nuk do ta zgjati me leximin e këtyre rekomandimeve por i mirpres pyetjet ose sygjerimet e juaja, (Shid dokumentin).

**z.Ruzhdi Jashari;** Është qështje jetike e një Komune që të jetë në nivel qështja e sigurisë. Në plan janë paraqitur të gjitha, por jo edhe qështja e narkomanisë, ku duhej të ishte një pjesë e veqantë, dhe do të duhej me u zbërthyer deri në detaje, sepse është një dukuri shumë e keqe dhe shqetësuese.

**z.Isak Muslija;** E kam shikuar dokumentin, mëépo Komuna në këtë fushë të sigurisë po mundohet të mbulohet vetëm sa për sy e faqe. Kjo sgurisht që kështu nuk funksionon deri sa në dokument nuk futen edhe aktivitetet konkrete. Nëse nuk kemi një drejtori kompetente për këtë fushë, nuk mund të kemi një situatë të qetë dhe stabile. U përmend aty në dokument edhe problemi ndër-fetar, unë kurrë deri më sot nuk kamë dëgjuar se në komunën tonë ka pasë ndonjë problem ndër-fetar. Unë nuk e di pse po e qesin

KKSB-ja një problem të tillë, a po reklamohet ky lloj problemi a qka është puna. Mendoj se qështja dhe trajtimi i qenëve endacak është një temë me të cilën më shumë duhet të merret ekzekutivi.

**Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi;** Rekomandimet e juaja do të merren parasysh, dhe do të vendosen në planin e punës të KKSB-së, jo nuk është problem për me i vendosur. Në komunën e Shtimes është e vërtetë që nuk kemi pas raste të tilla të problemeve ekstremiste fetare, mirëpo në dokument është përfshirë sipas rekomandimit të institucioneve qendrore. Pajtohem me ndryshimin e propozuar te rekomandimi i dytë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Planin e Punës të KKSB-ë për vitin 2020-21, duke përfshi edhe rekomandimet (propozimet) që dualën nga diskutimet në mbledhjen e Kuvendit.**

#### Pika 7

##### Informatë nga KKSB

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

**Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi;** Prezantoi informatën për punën e KKSB-së, duke lexuar pjesët kryesore të sajë. Në vazhdim ai tha se Informatën e keni marrë me kohë në formë të shkruar, mendoj se nuk ka nevoj që ta zgjas më shumë, jam këtu që të përgjigjëm në pyetjet e juaja eventuale. (shih dokumentin).

**z.Muhamed Ademaj;** Faleminderit për Informatën, gjendja e sigurisë në komunën tonë konsiderohet e qetë. Përkundër kësaj disa probleme i vërejmë në trafik. Kërkojmë prezencë të Policisë edhe nëpër fshatra. Pastaj prerja e pyjeve është duke ndodhur me të madhe, mendoj se duhet marrë masa për parandalimin e saj. Toka bujqësore është duke u degraduar me ndërtimë të ndryshme. Trajtimi i qenëve endacak është shqetësim edhe nëpër fshatra. Në fund mendoj se është e nevojshme edhe vendosja e kamerave të sigurisë.

**z.Isak Muslija;** Janë dy qështje të rëndësishme, që është mbrojtja e ambientit e që ka të bëj kryesisht me mbrojtjen e lumeve si dhe krijimi i deponive të egra. Kështu në këto kushte nuk ka hapsirë qytetari për me u ndie i sigurtë. Sa i përket mbrojtjes së pyjeve, duhet me e pyet policinë se cilat janë masat e juaja për mbrojtjen e pyjeve. Policia mundet me bërë parandalimin e prerjes së pyjeve. Vetëm kah Lumi Ranca për qdo ditë vijnë nga 4-5 Traktora plot me dru. Sa i përket pastrimit ose largimit të deponive të egra unë mendoj se në ato lokacione duhet edhe të vendosen shenja paralajmëruese për moshudhjen e mbeturinave. Unë mendoj se nevoitet urgjentisht një plan për parandalimin e prerjes së pyjeve.

**Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi;** Diskutimet janë të mirëseardhura, dëmtimi i pyjeve vërtetë po ndodhë dhe patjetër që duhet të ndërrmarrim diqka. Poashtu edhe për trajtimin e qenëve endacak duhet të ndërrmarrim diqka sepse përveq të tjerash mund edhe të bartin sëmundje të ndryshme. Kamerat e sigurisë janë duke funksionuar, ndërsa vendosja e tyre edhe nëpër fshatra kjo është kryekput qështje e buxhetit, DSHP dhe GVL-Natyra janë duke e bërë një punë të mirë. Pajtohem që ta bëjmë një plan për parandalimin e prerjes së pyjeve.

#### Pika 8

##### Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

**z.Ibrahim Demiri, Përgjegjës i ZKKK;** Përshëndetje, ne e kemi hartuar këtë program i cili realisht është në kontinuitet me programin e vjetër. Kuvendi pra ka vendosur më herët që ta qojë në diskutim publik. Përkundër kushteve të rënda nga KOVID19 ne kemi organizuar diskutimin me grupet e interesit. Ky program ka për qëllim të ndihmoj në zgjidhjen e banimit dhe strehimit për nevojtarët që janë pa kulëm mbi kokë. Kemi pas parasysh vendimin e Kuvendit për ndarjen e parcelës për këtë destinim në Lagjen e Pajtimit. Me këtë program kemi paraparë edhe ndërtimin e një banese kolektive për personat (familjet) me nevoja të mëdha për banim. Ne si ZKKK-ë deri tanë kemi bërë diqka, kemi ndërtuar 11 shtëpi, ndërkaq që 5 janë për komunitetin pakic. Miratimi i këtijë programi në Kuvend na

hapë rrugën për të konkuruar në projekte të nivelit qendror por edhe të Donatorëve. Me këtë program ne po kërkojmë ndarjen e një pjese të buxhetit të Komunës së shtimes në shumën prej 32.600€ përvitin 2021, si dhe përvitin 2022 poashtu 32.600€ ndërsa përvitin 2020 vetem 4000€ sa përtë siguruar qiratë e banimit përskamnorët. Kemi identifikuar 60 familje në nevojë të madhe përbanim. Unë po e përfundoj me kaq, i mirpres pyetjet dhe sygjerimet e juaja, pres që këtë program ta aprovon.

**z.Isak Muslija;** Shumica e juaj nuk keni qenë këtu kur është propozuar ky projekt. Fillimisht ka qenë ideja nga ekzekutivi që të ndërtohet një objekt përtë riatdhesuarit, që nënkuptonte që kemi njerëz që janë ikë prej Shtimes dhe ata do të riatdhesohen por ata nuk guxojn me ardhë sespe kanë vra e kan masakruar në Reqak etj.etj. Në atë kohë unë kam reaguar. Ndërasa Arbresha patë thënë po e humbim buxhetin përtë këtë qështje, e unë thash ja si ti shtish kta ktu ja bëjmë një kërkesh Beogradit dhe jo një por na jepin 10 milion veq me kthy njerëz kriminel që kan pre e kan masakru në këtë vend. Me përpjekjen time dhe të disa kolegëve ja kemi futë në mendje ekzekutivit të Komunës se në atë kohë kanë qenë rreth 600 familje nevojtare përbanim, dhe pytja ishte pse nuk është dashur me menduar për ato familje por po mendohet përdiqka që apsolutisht as që është dashur të mendohet. Me përpjekje të fuqishme kemi arritë që paraprakisht të konsultohen banorët e fshatit në Lagjen e Pajtimit. Ka qenë dhe është prioritare përekrahur këtë familje me bëdiqka në strehimin e tyre. Por përkundër kësaj deri tani nuk është bërë asgjë, tani besoj se do të bëhet diqka, unë jam përmes e përkrahur këtë program.

**znj.Arbresha Syla;** Po e mbanë në mend por jo bash bash mir. Ky pra ka qenë plan i Qeverisë. Unë duhet me e demantuar, sepse nuk jamë unë ajo që kisha dëshirë përmes u kthy Serbët. Ky pra ishte projekt i Qeverisë së Kosovës i mbështetur nga BE-ja. Edhe atëherë e kemi thënë se duhet me e përkrahur se janë fonde të BE-së, që dëshirojmë t'i marrim, dhe të cilin e kanë përkrahur të gjitha Qeveritë me rend. Unë edhe tash më parë e pyeta zyrtarin se a është gjetur ndonjë donacioni, se është e rëndësishme me e shfrytëzuar për nevoja të komunës. Asnjëherë unë e as si subjekt politik nuk e kam përkrahur idenë përmes u kthyer dikush i dyshimit. Jo vetëm tash por kurrë nuk jam e interesuar që me u kthyer kriminelët as këtu në Shtime e as kund në Kosovë.

**z.Isak Muslija;** Është e vërtetë që atëherë Kryeministri ka qenë Hashimi, ky pra Kryeministri zonjusha Arbresha ka pas thënë, se edhe nëse kthehen kriminelët ne i kemi Gjyqet këtu. Është e vërtetë se e ka përkrahur një projekt të gabuar. Unë jam shumë i kënaqur që emri i atijë projekti ka ndryshuar, sepse ka këtu familje të shumta që kanë nevojë përbanim kaq, unë nuk e kam shtu e as nuk e kam hjkë asnjë fjalë.

**znj.Adelina Beqa;** Ti lëmë anash fjalët e kaluara e ta përkrahim planin sepse është në të mirën e banorëve, ishalla skemi probleme. Është mirë që ti ndajmë disa mjete përtë objekt të banimit. Unë jam përmes e aprovar.

**z.Naim Zejna;** E falënderoj Komisionin për identifikimin e familjeve me gjendje të rëndë të banimit. Unë kam pasur një bisedë me banorët e Lagjes ku është ndarë parcela dhe ata janë shprehur se nuk janë të kënaqur me ndarjen e asaj parcele aty përbanim kolektiv. Kështu që ne si Kuvend duhet t'japim një zgjidhje të përshtatshme. Planifikime pa Hangju mos të bëjmë.

**z.Shekfi Dauti;** Më kujtohet edhe mua sepse nuk dishim se si me emërtuar atë projekt. Ne i kemi disa banesa nën menaxhimin e Komunës 7 prej banesave janë para Komunës, pse nuk i shesim ato dhe të bëjmë banesa të reja. Ne jemi Kuvend dhe duhet me iniciuar një gjë të tillë, pse me i lënë ashtu të amortizohen ato banesa. Unë them që ne të bëjmë një zgjidhje përtë këto banesa.

**z.Ruzhdi Jashari;** Pajtohem me diskutimin e parafolësit. Kemi këtu Bonus lidhur me qështjen e banimit përmes nevojarët. Ndërkakq që kemi familje që kanë nevojë imediate përbanim. Kemi pra banesa të komunës të pa shfrytëzuara. Këtu kemi keqmenaxhim prandaj kemi një gjendje të tillë. Kemi edhe Auditorin e brendshëm i cili kurrë nuk e ka pa këtë keqmenaxhim. Kjo thjeshtë është vepër penale dhe është punë e prokurorisë. Toka në Davidovc është dashur menjëherë me u bërë përtë interes të popullatës, këto i kemi potencuar ne disa herë. Banim kolektiv ka te "Fitorja", nuk ka banim social. Materialet janë nëpër Gjykata, dhe sigurisht që do të dalin ndonjëherë. Ne jemi përmes e përkrahur projektin me interes të popullatës.

**z.Fehmi Hysenaj;** E falënderoj zyrtarin për ekspozeun, mungoj sqarimi nëse ka pasur ndonjë input, nga diskutimi publik. Nuk është inkorporuar në dokument kapaciteti ekzistues i banimit të komunës. Te faqja 10 kemi të paraqitur ulje të natalitetit, ndërsa që te analiza SWOT thuhet se rreziku është shtimi i popullsisë. Përkundër këtyre unë do ta përkrahu dhe do ta votoj.

**z.Muhamed Ademaj;** Ne e kemi diskutuar këtë draft program për banim edhe në Komitetin për Komunitete. Te qështja e banimit është shqetësues fakti se 60 familje nuk kanë objekte banimi. Unë e mbështes ndërtimin e këtijë objekti për banim social. Ne duhet me e krijuar një kod të ri buxhetor dhe me i nda nga buxheti nga 32.600€ për vitin 2021 dhe 2022.

**z.Reshat Mujota;** E falënderoj zyrtarin për Draft-Programin, edhe unë do ta jap votën "për". Unë tu kisha lutë Kryesuese për me mbajtë pak korrektësi, sepse u përmend fjala për me dalë jashtë.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Unë po sqaroj se këtu asgjë nuk kishte personale, unë thash se "nëse keni për të diskutuar privatish diqka mund të vazhdoni përvjashta".

**z.Ibrahim Demiri, Përgjegjës i ZKKK;** Së pari sa i përket donatorit ende nuk dihet sepse tani për tani nuk kemi, por ne do ta qojmë programin në nivelin qendor dhe do të konkurojmë, por pa program as që mund të konkurojmë, një gjë është e qartë se ne asgjë nuk humbim por vetëm mund të fitojmë.

**znj.Diarta Vishesella;** Sot unë kam diskutuar dhe jam konsultuar me Kryetarin e Lagjës së pajtimit lidhur me këtë temë të parcelës për banim kolektiv, dhe ai më tha se ata nuk janë konsultuar fare për këtë temë. Kështu që unë kërkoj që të pyetet edhe Komuniteti.

**znj.Fatmire Ferati;** Është për keqardhje se far niveli të debatit po tregojmë. E përgëzoj Ibrahimin për debatin publik dhe për punën e bërë në Draft-Programin për banim. Ne jemi pra ata që më së paku marrim pjesë në debatin publik, ndërsa kritikat i kemi mjaft të ashpra, ndaj të tjerëve.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

**z.Naim Zejna;** Kemi edhe disa qështje të pa sqaruara, siq janë e para vendimi për buxhetin për këtë program, e dyta unë nuk pajtohem që ne me miratimin e këtijë programi të shkojmë direkt me ndërtimin e objektit për banim social në Lagjën e Pajtimit, pa marrë edhe pëlqimin e Komunitetit të Lagjës së Pajtimit.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi Kuorumin, prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Programin Komunal Trevjeqar për Banim, 2020-2022, me mundësinë e inkorporimit të rekomandimeve që kanë dalë nga anëtarët e Kuvendit.**

#### Pika 9

##### Shqyrtimi i Kërkesave

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Lexoi kërkesat, kërkesa e parë:

1. z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr."Hamëz Jashari" p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, Pastaj Kryesuesja lexoi edhe Rekomandimin e DPUKGJ-së dhe të Zyrtarit Ligjor, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

**z.Reshat Mujota;** Unë kërkoj që Lista e Kërkesave komplet të shtyhet për shqyrtim deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

**z.Naim Zejna;** Pajtohem me propozimin e Reshat Mujotës, me një shtesë të vogël që drejtoresha ta përgatitë një ekuivalencë nëse është e mundur për mbledhjen e ardhëshme, që e ka kry atë punë dhe kuptohet informatat shtesë për Reqak që i kemi kërkuar .

**z.Ruzhdi Jashari;** Plotësisht e mbështes propozimin e Reshat Mujotës, që të shtyhen të gjitha kërkesat për mbledhjen e radhës, sepse ka humbur interesimi i anëtarëve të Kuvendit, për mbledhjen e radhës përgatitjet le të bëhen më serioze.

**znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ;** Unë desha vetëm të sqaroj se unë nuk e kam asnjë material shtesë për kërkesën e Bahri Rexhaj, e vtmja që është kërkuar skica e parcelave që ua kam dhënë ndërsa asnjë koment tjetër për këtë kërkesë unë nuk mundem me dhënë, e keni Zyrtarin Ligjor, ai ka dhënë rekomandimin e tijë.

**z.Fehmi Hysenaj;** Edhe unë pajtohem për me u shty, por për mbledhjen e radhës, meqenëse ka humbur serioziteti por duhet me pas parasysh që në mbledhjen e radhës me pas më pak pika të rendit të ditës. Dhe ta kemi materialin e kompletuar.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Në bazë të diskutimeve dhe propozimit që u dha nga anëtari i Kuvendit z.Reshat Mujota dhe u përkrah nga një numër i anëtarëve të Kuvendit unë po e qes në votim propozimin e Reshat Mujota që pika e 9 e rendit të ditës "Lista e Kërkesave" të shtyhet për mbledhjen e radhës, mirëpo para se ta hedhi në votim, Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve të Kuvendit prezant në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës, unanimisht vendosi që ta shtyej për shqyrtim Listën e Kërkesave Npi-01/136, deri në mbledhjen e radhës të Kuvendit në muajin Gusht-2020, me arsyetimin që të merren më shumë informata.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 12.43h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit  
Medina Brahaj